



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT
KORÇË

KONTRATË SIPËRMARRJE

Lidhur sot, më datë 16/08/2017, midis :

AUTORITETI KONTRAKTOR:

Bashkia Korçë, Rruga "28 Nentori", perfaqesuar nga Kryetari Z.Sotiraq Filo, i quajtur me poshtë Investitori.

Dhe

KONTRAKTUESI:

Bashkimi i shoqerive "KACDEDJA"sh.p.k NIPT K51712017A dhe EVEREST "sh.p.k, NIPT J78311921L perfaqesuar me prokure Nr 7122/1 Rep dhe Nr 5541/1 Kol date 03.08.2017 nga shoqeria "KACDEDJA"sh.p.k me adresë: Tirane, Rruga Don Bosko, Pallati Meld, Kati i dyte, e cila perfaqeshet nga administratori Z.Skender Kacdedja i mëposhtë quajtur "Sipërmarrësi";

Neni 1

Baza ligjore

1. Kontrata do te qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve te Republikës se Shqipërisë.
2. Kontrata hartohet ne baze te dispozitiveve ligjore te parashikuara nga nenet 659 dhe ne vazhdim te Kodit Civil, ligjet 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar dhe VKM Nr 914 dt 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar.
3. Dokumentet e tenderit janë pjesë perberese e kesaj kontrate.





Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është sipërmarrja me objekt: "Rikonstruksion i ish godines te fonderise si projekt katalizator per zhvillimin ekonomik rajonal".



Neni 3

Vlera e Kontratës

Kontrata lidhet me një vlerë totale: 60.904.961 (gjashtedhjete milion e nenteqind e kater mijë e nenteqind e gjashtedhjete e nje) lek.

Vlera e vene ne dispozicion nga buxheti i shtetit per kete objekt per vitin 2017 eshte vlera 34,506,264 lek. Likujdimi financiar ne vitet ne vazhdim do te kryhet nga Ministria e Zhvillimit Urban duke u bazuar edhe ne ecurine e zbatimit dhe te realizimit te projekteve, programuar ne buxhet me shtrirje 2-3 vite.

Neni 4

Afati i Kontratës

Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Neni 5

Gjuha e Kontratës.

Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 6

Pëkufizime

6.1 "Preventiv" janë vëllimet e punës të plotësuara me çmime, pjesë përbërëse e ofertës.

6.2 "Skica (vizatimet)" përfshijnë projektet dhe të dhëna të tjera të paraqitura ose të miratuara nga Autoriteti Kontraktor për përbushjen e Kontratës.

6.3 "Mbikqyrësi i punimeve" është personi kompetent i emëruar nga Investitori dhe që i është njoftuar Sipërmarrësit, i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të punimeve dhe administrimin e kontratës.

6.4 "Drejtore Teknik i Punimeve" në objekt është personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor, përfaqësues i Sipërmarrësit, përgjegjës për kryerjen dhe përfundimin e punimeve, për të cilin Sipërmarrësi është i detyruar t'i konfirmojë Investitorit enrin e tij.

6.5 "Specifikimet" janë karakteristikat e punimeve të përfshira në projektet e zbatimit në dokumentat standarde të tenderit dhe çdo modifikim ose shtesë e bërë dhe e miratuar me shkrim nga Investitori.

6.6 "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve, e vertetuar nga autoriteti kontraktor.



6.7 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

6.8 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Investitori se Punët janë mbaruar.

6.9 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

6.10 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

6.11 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.





6.12 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që sipermaresi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

6.13 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

6.14 "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me atë te perkufizuar ne ligj.

6.15 "Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.

6.16 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të sipermaresit.

6.17 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

6.18 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si irregulla, irregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

6.19 "Ngritura e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

6.20 "Punime" (*te cilat do te kryhen ne masen 70 % nga shoqeria "KACDEDJA" sh.p.k dhe 30% nga shoqeria "EVEREST" sh.p.k, kjo sipas Kontrates per bashkin e perkozhshem te shoqerive Nr 7122 Rep dhe Nr 5541 Kol*), do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizua në dokumentat e tenderit.

Neni 7

Komunikimi

7.1 Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim në adresat e deklaruara nga palët, në rast se ka ndryshim të adresës palët janë të detyruara të informojnë për çdo ndryshim. Njostimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet.

Neni 8

Prona Intelektuale

8.1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Investitorit, i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

8.2. Me përjashtim të rasteve kur palët bien dakort ndryshe, Sipërmarrësi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Investitorit të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregaritura nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit të kontratës. Sipërmarrësi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënavë, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Invesitori

8.3. Sipërmarrësi duhet të garantojë Investitorin zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prona tjetër sipas kontratës.

8.4. Në rast se ngrihrt ndonjë pretendim ose padi kundër Investitorit në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prona tjetër të mbrojtur të furnizuari sipas kontratës, Sipërmarrësi duhet t'i japë Investitorit të gjitha provat dhe informacionin në posedim të tij që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

8.5 Ne perfundim te punimeve sipermarresi duhet ti dorezoje investitorit ne formatin DWG te gjitha puniet e ndertimit qe ka kryer (as built)

Neni 9

Mbikqyrësi i Punimeve



9.1. Mbikqyrësi i punimeve do të jetë personi i perzgjedhur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me anëtarët e kontratës te vecante.

9.2. Detyrat e mbikqyrësve të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi dhë detajohën në kontratën e shërbimit që do të lidhet me këta të fundit.

9.3. Në rast se mbikqyrësi do të ndryshohet, Investitori njofton menjëherë Sipërmarrësin.

Neni 10

Personeli i Sipërmarrësit.

10.1. Sipërmarrësi do të punësojë vetëm personelin e deklaruar në ofertë për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyrësi i Punimeve. Mbikqyrësi i Punimeve do t'i propozojë Investitorit për të zëvendësuar personelin kryesor, vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe astësitet e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Sipërmarrësit.

10.2. Në qoftë se Mbikqyrësi i Punimeve i kërkon Sipërmarrësit që të largojë një person, i cili është anëtar i personelit ose i fuqisë punëtore të Sipërmarrësit, duke theksuar arsyet. Sipërmarrësi do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në kontratë.

10.3. Drejtor Teknik i Punimeve do te jete :**Ing.Suzana Mullahaj**

Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:

- Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit;
- Dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet në objekt;
- Korrespondencën zyrtare me Mbikqyrësin e Punimeve;
- Ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve;
- Është i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.

10.4. Në rast se ndryshohet Drejtori Teknik, Sipërmarrësi duhet detyrimisht të lajmërojë Mbikqyrësin e Punimeve i cili ve në dijeni Investitorin.

Neni 11

Detyrimet e Sipërmarrësit

11.1. Sipërmarrësi do të kryejë punimet në përputhje me projektet e ndryshimet e miratuar, dhënë nga Investitori dhe në përputhje me K.T. të zbatimit të R.SH. – së

11.2. Drejtori Teknik i Punimeve në kantier, është i detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku do të përfshihen të gjitha punimet e kryera dhe urdhërat e dhëna për zbatimin e projektit. Ky ditar në çdo kohë do t'i vijet në dispozicion Mbikqyrësit të Punimeve, grupit të Kolaudimit dhe Investitorit.

11.3. Sipërmarrësi do të kryejë punime me nënsipërmarrje pasi të ketë marrë miratimin e Investitorit. Marrëdhëniet e n/sipërmarrjes do të irregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje, e cila përcakton qartë nënsipërmarrjen dhe në çdo rast është e detyruar të respektojë të gjitha detyrimet e kontratës së sipërmarrjes. Përgjegjës ndaj Investitorit mbetet gjithmonë Sipërmarrësi kryesor i punimeve.


11.4. Sipërmarrësi ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Investitorit.

11.5. Sipërmarrësi është i detyruar të marri të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Abjentit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.

11.6. Sipërmarrësi është i detyruar të përdori të gjitha mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.

11.7. Sipërmarrësi është i detyruar të pajisë punonjësit e tij në objekt me uniforma, në të cilat të jenë shprehur shenjat dalluese të shoqërisë Sipërmarrëse.

11.8. Në rast të mosrespektimit të parashikuara në pikat 11.5.-11.7 të mësipërmës Mbikqyrësi i punimeve i bën njoftim Sipërmarrësit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Sipërmarrësi nuk meir masa brenda 10 ditëve nga mafja e njoftimit atëherë Mbikqyrësi i punimeve i





propozon Investitorit aplikimin e penaliteteve në masën e caktuar në legjislacionin Shqiptar ne fuqi , penalite te cilat do të mbahen nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.



Neni 12

Testimet dhe Inspektimet

12.1. Sipërmarrësi është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt, si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mbikqyrësi i Punimeve.

12.2. Sipërmarrësi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkua nga dispozitat e kontratës kosto e këtyre testimeve dhe inspektiveve duhet të financohet tërësisht nga Sipërmarrësi, brenda kushteve të çmimit të kontratës.

12.3. Investitori gjithashtu duhet t'i kërkojë Sipërmarrësit të bëjë testime dhe inspektime shtesë të pa parashikuara në kontratë, por të gjykuara të nevojshme për të vërfikuar se ndërtimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës.

12.4. Investitori do të refuzojë çdo punim ndërtimi që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkua të zbatimin e kontratës.

12.5. As egzekutimi i testeve, as inspektimi i punimeve të ndërtimit nuk do ta lirojë Sipërmarrësin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 13

Ngritja e Kantierit

13.1. Sipërmarrësi do të mbajë përgjegjësi për skicimin e Ngritjes së Kantierit.

13.2. Sipërmarrësi duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Mbikqyrësi i Punimeve për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 14

Zbulimet

14.1. Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Sipërmarrësi duhet të njoftojë Mbikqyrësin e Punimeve për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e mbikqyresit te punimeve për procedurën e e administritmit të objekteve.

Neni 15

Sigurimi Teknik dhe mjedisor

15.1. Sipërmarrësi është përgjegjës për sigurine e te gjitha aktivitetave ne kantjer duke zbatuar masat korriguese dhe irregullat e sigurimit teknik për të gjithë personelin sikurse përcaktohet në legjislacionin Shqiptar.

15.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varféruese të ozonit, clirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 16

Rreziqet e Sipërmarrësit dhe Forca Madhore

16.1. Sipërmarrësi ka për detyrë të përballojë të gjitha shpenzimet që mund të dalin nga data e fillimit të punimeve deri në fund të periudhës së garaçisë për difektet që mund të shfaqen në objekt sipas të dhënavë të kontratës. Sipërmarrësi deri në përfundim të punimeve do të përballojë rreziqet për shkak të



dëmtimit e personelit, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe pajisjet, kantierin e ndërtimit si dhe objektin e ndërtimit).

16.2. Sipërmarrësi nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës jo për fajin e tij, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcave Madhore.

16.3. Për qëllimet e këtij nenit "Forçë Madhore" do të shotë një ngjarje jashtë kontrollit të Sipërmarrësit dhe e paparashikuveshme. Ngjarje të tillë mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Investitorit qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, përblytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

16.4. Nëse ndodh ndonjë situatë e Forçës Madhore, Sipërmarrësi duhet të njoftojë menjëherë Investitorin. Me përjashtim kur Investitori jep direktiva të ndryshme, Sipërmarrësi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin e kontratës deri që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 17

Preventivi

17.1. Preventivi do të përfshijë të gjitha zërat e punimeve me çmimet përkatëse të parashikuara në ofertë.

17.2. Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Sipërmarrësi paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit.

17.3. Për zërat e reja, të paparashikuara në Preventiv përvèç dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike për çdo zë të ri pune.

17.4. Nënëzërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë.

Neni 18

Negociatat dhe Amendamentet

18.1. Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnje elementi të kontratës që do të ndryshojë mjafueshëm kushtet që kanë përbërë bazën e përzgjedhjes së Sipërmarrësit.

18.2. Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë dhe duke iu referuar shprehimisht kontratës. Çdo shtesë ose ndryshim Amendamenti do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se nënshkruhet nga të dyja palët ose nga persona të autorizuar prej tyre.

18.3. Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhen me shkrim, në të cilën të specifikohet data dhe të nënshkruhen nga pala ose nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 19


Ndryshimi i Porosisë

19.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi, bëhet vetëm me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe i nënshkruar nga Investitori dhe Sipërmarrësi.

19.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontratës.

19.3 Investitori mund që në çdo kohë mund të porositë Sipërmarrësin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilën prej e sa më poshtë:

- Korrigjime në skicimin, vizatimin ose specifikimin e Ndërtimeve;
- Korrigjime në materiale;
- Korrigjime në sasi.



19.4. Përpara se të kërkojë një ndryshim, Investitori dhe Sipërmarrësi duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në skedimin e dorëzimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të trupëzojë amendamentet e marrëveshjes. Investitori nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur, përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrëveshjes.

19.5. Ndryshimi i porosisë nuk do të jetë i vlefshëm në se nuk formalizohet sipas kërkësave të Nenit 18 të kësaj kontrate.

19.6. Çdo ndryshim i urdhëruar nga Investitori, do të jetë detyrimisht objekt i një proces-verbal (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Investitori. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Investitorit dhe në bazë të llogarive përkatëse të bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune të shprehur në preventiv.

19.7. Çdo ndryshim i cili sjell iritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi pregetitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohet zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.

19.8. Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit dhe fondit rezervë të parashikuar në preventiv, Investitori ngarkon Mbikqyrësin për të verifikuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato.

Neni 20

Programi

20.1. Brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës Sipërmarrësi do t'i paraqesë për miratim Mbikqyrësit të Punimeve një program, në të cilin tregohet mënyra e kryerjes së punimeve dhe grafiku kohor. Sipërmarrësi do të realizojë programin sipas grafikut të parashikuar. Sipërmarrësi ka të drejtë t'i propozojë Mbikqyrësit të Punimeve ndryshime në grafikun e punimeve, duke i motivuar ato.

20.2. Në rast se mund ose lind nevoja e dorëzimit të pjesshëm të punimeve këto parashikohen në grafikun e punimeve ose në ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga Investitori.

Neni 21

Korrigimi i Difekteve

21.1. Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga Mbikqyrësi konstatohet një difekt Sipërmarrësi është i detyruar ta korrigjojë atë brenda afatit që i lihet me shkrim, por jo më vonë se 15 ditë.



21.2. Gjatë periudhës së garancisë së punimeve Mbikqyrësi i punimeve do të njoftojë Sipërmarrësin lidhur me çdo difekt para imbarimit të kësaj periudhe. Për eliminimin e difekteve lihet një afat i cili saktësohet sipas çdo rasti konkret, por jo më shumë se 15 ditë.

21.3. Periudha e garancisë për difektet është afati 24 muaj. Me përfundimin e kësaj periudhe Sipërmarrësi paraqet kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit, brenda 10 ditëve organizon vizitën në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lëna nga korrigimi i difekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Nëse janë kryer gjithë korrigimet e difekteve atëherë hartohet akti përkatës i marjes në dorëzim të objektit dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të mbikqyrjes së punimeve.

Neni 22

Difektet e Pakorrigjuara

22.1. Në qoftë se Sipërmarrësi nuk korrigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, brenda afatit të përcaktuar Investitori do të vlerësojë koston e korrigimit të difektit, dhe Sipërmarrësi do të paguajë këtë shumë, së bashku me një gjobë të veçantë e cila do të jetë 0.04% të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Investitori do të mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila është mbajtur progresivisht në situacione.



22.2. Nëse me përfundimin e periudhës së garancisë Sipërmarrësi nuk ka korriguar difiketë e konstataura, Investitori i zbret nga garancia deri në konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.



Neni 23

Situacionet

23.1. Sipërmarrësi do t'i paraqesë Mbikqyrësit të Punimeve brenda 5 ditëve të para të çdo muaji situacionet mujore progresive për punimet e kryera, duke zbritur pagesat e situacioneve të mëparshme, garancinë e difikteve, paradhënien etj., të kësaj natyre, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.

23.2. Mbikqyrësi i Punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga Sipërmarrësi dhe do të vërtetojë shumën që duhet t'i paguhet Sipërmarrësit brenda 10 ditëve nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit Mbikqyrësi përcakton vlerën e punimeve të kryera.

23.3. Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventiv, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të kompèsuara pa prekur fondin rezervë, i cili do të financohet në situacionin përfundimtar në se ka dokumenta që argumentojnë përdorimin e tij.

Neni 24

Pagesat

24.1 Pagesat për çdo situacion punimesh do të kryhen nga Investitori brenda 30 ditëve nga dita e firmosjes së situacionit nga Mbikqyrësi i Punimeve.

Pagesat e situacioneve do të kryhen në numrin e llogarisë bankare të shoqerise KACDEDJA sh.p.k , ne Banken Kombetare Tregetare IBAN AL5020511014057731CLPRCLALLE.

24.2. Pagesa e situacionit do të kryhet sipas financimit të parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

Neni 25

Rastet e Kompesuara

25.1. Rastet e kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohen si vijojnë:

- Mbikqyrësi i Punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specifikimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar;
- Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon Sipërmarrësin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve;
- Autoritetet Publike ose Investitori shkaktojnë vonesa në lirimin e sheshit të ndërtimit për Sipërmarrësin;
- Investitori vonon, pa arsy, lëshimin e certifikatës së marijes në dorëzim;
- Pezullimi i punimeve per shkaqe te arsyeshme me propozim te supervizorit dhe ne cdo rast me miratimin e Investitorit.

25.2. Kompensimi i rasteve të sipërpërmendura do të bëhet si vijon:

Për vonesat e përmendura në pikat 25.1 (a,b,c,d,e) Investitori do të njohë shtyrjen e datës së përfundimit të punimeve mbi atë të parashikuar në këtë kontratë. Dokumentacioni që verteton vonesat, i konfirmuar nga palet (Mbikqyrësi, Investitori dhe Sipermarresi), i bashkengjitet kontrates dhe behet automatikisht amendament i kesaj kontrate .



Neni 26
Taksat

26.1. Sipërmarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

26.2. Për taksat e përcaktuara në legjislacionin që ka hyrë në fuqi 28 ditë para datës së hajjes së tenderit, të cilat Sipërmarrësi duhet t'i ketë marrë parasysh në vlerën e kontratës, Investitori nuk do t'i njohë asnjë shëtesë pagesë.

Neni 27

Dëmshpërbimi për Vonesat

27.1 Sipërmarrësi do t'i paguajë Investitorit dëmshpërbimin për vonesa në mbarimin e punimeve sipas tarifes te me poshtme ditore:

-tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

27.2. Investitori do të zbresë dëmshpërbimin për vonesat nga pagesa e fundit e Sipërmarrësit.

Neni 28

Garancia e Difekteve

28.1. Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së kontratës që do t'i mbahet nga çdo situacion Sipërmarrësit si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, duke marrë parasysh edhe sankzionet e parashikuara në pikën 22 të kësaj kontrate.

Neni 29

Kostoja e Riparimeve

29.1. Dëmtimi i punimeve osc humbja e materialeve që do të përdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim, si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij nëqoftëse humbja ose dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

29.2. Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësimit të kontratës ose të punës jo cilësore të Sipërmarrësit, do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

Neni 30

Marrja në Dorëzim e Punimeve

30.1. Sipermaresi pas perfundimit te punimeve njofton me shkrim Mbikqyresin e Punimeve dhe Investitorin. Nese Mbikqyresi nuk ka verejtje ky njoftim shenon daten e perfundimit te punimeve. Sipermaresi pas njoftimit te perfundimit te punimeve i paraqet brenda 30 diteve Mbikqyresit te Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare per punimet e kryera. Mbikqyresi i Punimeve, mbas verifikasi, brenda 30 diteve se bashku me relacionin e tij ia paraqet te gjithe dokumentacionin Investitorit.

30.2. Mbas marrjes se gjithe dokumentacionit Investitori i paraqet komisionit te kolaudimit gjithe dokumentacionin e realizimit te objektit. Me perfundimin e procedureve te kolaudimit Investitori lehon certifikaten e marrjes ne dorezim te punimeve te kryera dhe do te ciliroje garancine e sigurimit te doktratës. Nga data e akt-kolaudimit te punimeve fillon periudha e garancise se punimeve.

30.3. Ne fund te periudhes se garancise se punimeve, Mbikqyresi i Punimeve dhe komisioni i marrje ne dorezim te objektit do te perpilojne se bashku me Invesitorin aktin e marrjes ne dorezim te vepres, objekt i kesaj kontrate.





Neni 31
Zgjidhja e Kontrates

- 31.1 Investitori ose Sipermaresi mund te zgjidhin kontraten kur veren shkelje themelore te saj.
- 31.2 Shkelje themelore te kontrates perfshijne por nuk kufizohen ne sa vijon:
- Sipermaresi nuk fillon pune brenda 5 diteve nga neneshkrimi i kontrates si edhe ne rastet kur ndalohen punimet me shume se 10 dite, kur nuk parashikohet ne programin e punes dhe ndalimi i punimeve nuk eshte i autorizuar nga Mbikqyrsi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.
 - Mbikqyresi i Punimeve udhezon pezullimin e punimeve, duke njoftuar Invesitotrin dhe Sipermaresin.
 - Sipermaresi falimenton ose fillon likuidimin per arsyte tjetra pervec rindertimit ose bashkimit te shoqerise.
 - Sipermaresi vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korrigimet e defekteve te propozuara nga Mbikqyresi i Punimeve.

Neni 32

Pagesa pas Zgjidhjes se Kontrates

32.1 Ne rast se kontata prishet nga Investitori per arsyte objektive, Mbikqyresi i Punimeve do te leshoje nje certifikate per vleren e punes se kryer duke zbritur pagesat e marra deri ne daten e leshimit te certifikates.

Neni 33

Ndërprerja për Mosplotësim

33.1 Autoriteti Kontraktor mund te ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

33.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëherëshe.

33.3 Të gjitha materialet, Ngritura e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

Neni 34

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

34.1 Autoriteti Kontraktor mund te ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

34.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.


Neni 35

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

35.1 Autoriteti Kontraktor mund te ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

35.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

35.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin përgjitha Punët e pranuara dhe të kryera përpëra ndërprerjes që duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesës së tij.





Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.



Neni 36 Pasuria

36.1 Te gjitha punimet e kryera dhe materialet e montuara per realizimin e objektit do te konsiderohen si prone e Investitorit ne rast prishje te kontrates.

Neni 37 Zgjidhja e Mosmareveshjeve

37.1 Investitori dhe Sipermaresi do te zgjidhin me mirekuptim cdo mosmareveshje qe do t'u linde gjate realizimit te kesaj kontrate.

37.2 Ne rast se palet nuk bien dakort atehere per sqarimin e mosmarveshes me mirkuptim atehere palet do t'i drejtohen Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Korce.

Neni 38 Garancia e Kontrates

38.1 Garancia e kontrates do te jetë 10% e vleres se kontrates.

38.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 39 Dispozita te Fundit

Personi perjegjes i cili do te ndjeke zbatimin e kontrates ne perputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura ne te eshte Drejtori i Drejtore te Menaxhimit te Kontratave.

Kjo kontrate u hartua ne 6 (gjashte) kopje, nga te cilat nje per Dosjen e Prokurimit, nje per Drejtore te Menaxhimit te Kontratave nje per Drejtore te Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Teritorit, nje per Drejtore te Finances nje per veprimet me Thesarin dhe tjetra per Furnizuesin.

SIPERMARRESI

INVESTITORI

Bashkimi i shoqerive "KACDEDJA" sh.p.k
dhe "EVEREST" sh.p.k

perfaqesuar nga :

Administrator i shoqerise "KACDEDJA" sh.p.k

SKENDER KACDEDJA
Sh.p.k.

Administrator i shoqerise "EVEREST" sh.p.k

SOÑOL E CUBI
REPOBLIKË SË KUËS
"EVEREST"
Sh.p.k.
TIRANË - ALBANIË

BASHKIA KORCE
perfaqesuar nga

KRYETARI

SOTIRAQ FILO
BASHTA KORCE